



Pranimi / Dostava Received / Delivered	01.12.2023	3	viti / god. year
Organ / Agjencia Org. / Unit	SKOMSHUK	7204/2023	117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1237/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1237/2023 të datës 02.10.2023, të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër protokoll Nr.prot.2357 të datës 20.09.2023 të Ministres së Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 01.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1237/2023 e datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesi ashtu që aprovohet pretendimi lidhur me kontestimin e kompetencës së organit që ka nxjerrë vendimin e kundërshtuar me ankesë, ndërsa refuzohet pretendimi ankimor lidhur me kthimin e ankuesit në pozitën e punës sipas Akti të Emërimit të datës 03.10.2016.
- II. **Anulohet** Vendimi me numër protokoll Nr.prot.2357 i datës 20.09.2023 të Ministres së Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- III. **Obligohet** Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të bëjë sistemimin e ankuesit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit sipas Akt Emërimit të datës 03.10.2016 në pozitën e punës „Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoriatit të Arsimit“, më datë 20.09.2023 Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka nxjerr Vendimin me numër protokoll Nr.prot.2357 përmes të cilit e ka shfuqizuar Akt Emërimin e datës 03.10.2016 të ankuesit, në pozitën e punës „Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoriatit të Arsimit“, duke e obliguar Njësinë përgjegjëse të Departamentit për Menaxhimin e Zyrarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme që ta bëjë sistemimin e tij.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoll Nr.prot.2357 të datës 20.09.2023 të Ministres së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, më datë 02.10.2023 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6352/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Inspektoratin e Arsimit/Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Ndërsa Këshilli më datë 19.10.2023 ka pranuar nga Inspektorati i Arsimit/Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar me numër Nr.prot.1237/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër: VK/2023 dhe numër protokoll Nr.prot.6352/2023 të datës 15.11.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1237/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokoll 6352/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar Avokat [redacted] në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 29.09.2023; Përgjigjen në kërkesën me numër Nr.2495 të datës 08.06.2023 dhe të pranuar nga MPB me datë 09.06.2023 me numër Nr.867 për vlerësimin e ligjshmërisë rreth afatshmërisë së aktemërimeve për tre (3) pozita të larta drejtuese në sistemin ministror të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit me referencë: DMZP-MPB 06/2023; Vendimin për shfuqizimin e Akt Emërimit me numër protokoll Nr.prot.2357 të datës 20.09.2023 të nxjerr nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Kontratën e Punës me numër: 1/2007 të datës 01.10.2007; Kontratën e Punës me numër: 2/2010 të datës 30.09.2010; Akt Emërimin e datës 30.09.2013; Akt Emërimin e datës 07.10.2016; Ngritjen e koeficientit të pagës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me referencë: DASHC/MAP-04/167 të datës 04.02.2015; Vendimin me numër A 02/422/2016 të datës 09.11.2016 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rregulloren (MASHT) Nr.01/2019 për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të Inspektoratit të Arsimit në Republikën e Kosovës të datës 13.05.2019; Organogramin e Inspektoratit të Arsimit në Republikën e Kosovës; Ligjin me numër Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 13.05.2010; Kërkesën për përgjigje në ankesë

të datës 16.10.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli Nr.prot.1237/2023 të datës 19.10.2023; Vendimin me numër A/02/178/2016 të datës 04.08.2016 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil të Kosovës; E-mailin e datës 06.04.2016 nga L.M drejtuar N.SH-A; Përshkrimin e detyrave të punës; Faqen me numër 22 të Ligjit Nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës; Kërkesën me referencë: 01B-065 për vlerësimin të ligjshmërisë së afatshmërisë së akt-emërimeve për tre pozita të larta drejtuese në MASHT të datës 08.06.2023; Plikon nga Inspektorati i Arsimit; Vendimin me numër VK/2023 dhe numër protokolli 6987/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi **është e pjesërisht e bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesi, sipas Kontratës së punës me numër 01/2007, të datës 01.10.2007 kishte themeluar për here të parë marrëdhënien e punës në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në pozitën e punës „Drejtor i Departamentit të Inspektimit“ marrëdhënie kjo e punës e cila ishte lidhur me afat të caktuar në kohëzgjatje prej tre (3) vite, nga data 01.10.2007 deri më datë 30.09.2010 me mundësi vazhdimi; po ashtu me Kontratën e Punës me numër të kontratës: 2/2010 të datës 01.10.2010 ankuesit i është vazhduar marrëdhënia e punës në pozitën e punës „Drejtor i Departamentit të Inspektimit të Arsimit“ në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, edhe për tre (3) vite, dhe atë nga data 01.10.2010 deri më datën 30.09.2013. Ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i MASHT, me datë 30.09.2013, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 96 dhe 97 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht pas vlerësimit pozitiv të rezultateve të punës për periudhën kohore nga data 01.10.2010 deri më datën 30.09.2013, Kontratën e punës se ankuesit e kishte shndërruar në Akt Emërim me afat të pacaktuar/karrierës në pozitën e punës „Drejtor i Departamentit të Inspektimit të Arsimit“ në Departamentin e Inspektimit, dhe atë me fillim nga data 01.10.2013 me koeficientin dhjetë (10). Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se Drejtor i Departamentit të Inspektimit të Arsimit ka parashtruar kërkesë tek Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, duke kërkuar ngritjen e koeficientit të pagës për titullin e Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit, ndërsa më datë 06.02.2015 Drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, përmes shkresës me numër protokolli Nr.prot. 667, e aprovon kërkesën e ankuesit lidhur me ngritjen e koeficientit të pagës për titullin e pozitës „Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit“ me koeficientin 16 me arsyetimin se „Bazuar në Strukturën e re organizative të MASHT-it, Rregulloren NR. 39/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Formularin PCF-2, me të cilin dëshmohet se janë planifikuar mjete buxhetore për vitin 2015, për postin e lartpërmendur si dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi në punë, në bazë të kriterëve për vlerësimin e detyrave të vendit të punës, përgjegjësisë, kompleksitetit, aftësi komunikuese ndërpersonale dhe shkathtësi tjera që kërkohen për këto vende të punës DASHC/MAP aprovon ngritjen e koeficientit të pagës për titullin e vendit të punës: „Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit në MASHT“ me koeficientin 16 dhe për pasoj Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 03.06.2016 e ka ndryshuar Akt Emërimin e datës 01.10.2013 dhe i ka ofruar ankuesit Akt Emërimin me afat të pacaktuar, për pozitën e punës „Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit“ me koeficientin 16.

Ankuesi në ankesën me numër protokolli 6352/2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Ministria e Arsimit, Shkencës,

Teknologjisë dhe Inovacionit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll Nr.prot.2357 të datës 20.09.2023, përmes të cilit ka shfuqizuar Akt Emërimin e tij të datës 03.10.2016, ka shkelur dispozitat e ligjit material dhe ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa për sa i përket opinionit ligjor të dhënë nga Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme mbi bazën e të cilit është mbështetë vendimmarrja është i kundërligjshëm për arsye se „*opinion ligjor*” nuk ka karakter obligativ, respektivisht nuk e ka obliguar Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të nxjerr Vendim për shfuqizimin e Akt Emërimin, pozitën e Drejtorit të Inspektoratit të Arsimit në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit/Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ankuesi e ka fituar pas zhvillimit dhe përfundimit me sukses të procedurave të rekrutimit në vitin 2013, ndërsa pas vlerësimeve pozitive të dy viteve të fundit ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit i ka ofruar Akt Emërim pa afat të kufizuar, Vendimi i kontestuar me ankesë është në kundërshtim edhe me Ligjin me numër Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 47 dhe 48 paragrafi 1.4 për shkak se arsyetimi i Vendimit përmes të cilit ankuesit i është shfuqizuar Akt Emërimi nuk përmban bazën ligjore të Vendimit dhe arsyen pse është zbatuar në rastin konkret, vendimi i kontestuar me ankesë është në kundërshtim edhe me nenin 52 dhe 53 të Ligjit me numër Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse në njërin anë ankuesi në pozitën e punës Drejtor i Inspektoratit të Arsimit është pranuar sipas procedurave të rregullta të rekrutimit, ndërsa Akt Emërimin e kishte fituar në bazë të ligjit, ndërsa organi që ka nxjerr vendimin nuk është kompetent duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe kërkon nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të aprovohet ankesa e ankuesit Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe i njëjti të kthehet në pozitën e tij të punës sipas Akt Emërimin të datës 03.10.2016, me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësit nga marrëdhënia e punës, si dhe të anulohet Vendimi me numër protokoll Nr.prot.2357 i datës 20.09.2023 i nxjerr nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi me numër protokoll Nr.prot.2357 i datës 20.09.2023 të Ministres së Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me të cilin është shfuqizuar Akti i Emërimin i datës 03.10.2016 për pozitën e punës „*Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit*” është nxjerr përmes shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit, nën supozimin se pozita e „*Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit*” nuk është pozitë e kategorisë së lartë drejtuese, analizoi legjislacionin përkatës që rregullon organizmin dhe funksionim e *Inspektoratit të Arsimit*, si dhe dispozitat përkatëse që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, gjegjësisht:

- Ligjit Nr.06/L-049 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të ku është përcaktuar se „*Drejtor i përgjithshëm është shërbyesi civil i rangut më të lartë në Inspektoratin e Arsimit*” si dhe nenin 4 ku përcaktohet qartë se „*Inspektorati i Arsimit është organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë, në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë*”.
- Ligjin r.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (i aplikueshëm nga data 10.07.2010 deri me datë 09.07.2020), përkatësisht nenin 23 ku përcaktohej se: “1. Personeli i punësuar në Shërbimin Civil ndahet në katër (4) kategori funksionale: 1.1. nëpunës civilë të nivelit të

lartë drejtues; 1.2. nëpunës civilë të nivelit drejtues; 1.3. nëpunës civilë të nivelit profesional; 1.4. nëpunës civilë të nivelit tekniko – administrativ” duke u ndërlidhur kështu edhe me nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: “Vendet e punës në institucionet e nivelit qendror dhe lokal në Shërbimin Civil ndahen në katër kategori funksionale: Niveli i Lartë Drejtues, është pozitë përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm administrativ të institucionit të administratës publike në shërbimin civil.

- Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik (i aplikueshëm nga data 10.07.2020), përkatësisht dispozitat e nenit 33 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “*Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë” ndërlidhur këtu edhe me nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 5 dhe 10 të Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: “4. Në pajtim me ligjin për zyrtarët publik, pozitat e punës në shërbimin civil dhe institucionet e administratës së shërbimit publik ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. kategoria e lartë drejtuese; 5.1. Kategoria e lartë drejtuese është kategoria më e lartë e menaxhimit të një institucioni që ka përgjegjësinë për hartimin e politikave dhe këshillimin rreth tyre. Pozitat e kësaj kategorie janë përgjegjës për të: 1.1. përcaktuar objektivat dhe hartuar programet, standardet dhe procedurat përkatëse për zbatim; 1.2. siguruar përdorimin efikas të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe arritjen e objektivave; 1.3. planifikuar dhe drejtuar veprimtarinë e përditshme administrative të institucionit; 1.4. përfaqësuar atë në takime dhe forume brenda dhe jashtë vendit.” 10. Klasat përbërëse të kategorisë së Lartë Drejtuese dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Drejtues i Lartë 2. Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Ekzekutive ”.*
- Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht nenin 12 ku përcaktohet se: *Agjencia Ekzekutive themelohet për të kryer funksionet administrative brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të një ministrie apo Zyrës së Kryeministrit, si në vijim: 1.1. zbatimin e ligjit, duke zgjidhur çështje individuale dhe duke kryer veprime administrative sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative; 1.2. mbledhjen e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore, kontributeve apo detyrimeve të tjera dhe menaxhimin e tyre për qëllimin për të cilin janë krijuar; 1.3. mbrojtjen e sigurisë publike nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve policore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike dhe kryerjen e inspektimeve; 1.4. mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe informacionit për Qeverinë; 1.5. ushtrimin e përbashkët të funksioneve të brendshme mbështetëse. 2. Agjencia Ekzekutive themelohet me ligj”, kurse me nenin 22 është përcaktuar se: 1. Agjencia Ekzekutive drejtohet nga drejtori ekzekutiv. 2. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë. 3. Drejtori ekzekutiv për performancën dhe veprimtarinë e Agjencisë, i përgjigjet ministrit dhe informon Sekretarin e Përgjithshëm.*
- Ligjin Nr.08/1-067 për Inspektimet gjegjësisht neni 7 paragrafi 1, 2 dhe 3 përcaktohet se: “1. Inspektoratet qendrore organizohen dhe funksionojnë si agjenci ekzekutive në vartësi të ministrit përgjegjës për fushën përkatëse të veprimtarisë shtetërore (në vijim “ministri përgjegjës”). 2. Inspektoratet qendrore ushtrojnë juridiksionin në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Sipas nevojës,

një inspektorat qendror mund të organizohet edhe në degë lokale. 3. Inspektoratet qendrore udhëhiqen nga drejtori ekzekutiv, që është gjithashtu edhe kryeinspektor i inspektoratit qendror përkatës". 4. Inspektoratet qendrore në Republikën e Kosovës përcaktohen në Shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji..... konkretisht në Shtojcën e ligjit të lartpërmendur janë listuar inspektoratet qendrore dhe njësitë e veçanta inspektuese respektivisht në piken 1 nënpika 1.4 është përcaktuar edhe inspektorati i Arsimit si Inspektorat qendror ku decidivisht theksohet se: 1.4 Inspektorati Qendror i Arsimit, në kuadër të Ministrisë Përgjegjëse për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, është përgjegjës për: 1.4.1. inspektimin e institucioneve dhe profesionistëve të arsimit; 1.4.2. inspektimet që ndërliken me akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Rrjedhimisht, bazuar në kuadrin ligjor si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se pozita e Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit me afat te pakufizuar sipas Akt emërimit të datës 03.10.2016 është pozitë e Nivelit të Lartë Drejtues, në kuptim të nenit 23 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil, akte këto të aplikueshme në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në kohën e nxjerrjes së aktit të emërimit i cili është shfuqizuar nga organi përkatës i punësimit. Ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik respektivisht me nenin 33 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, si dhe nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ndërlidhur me nenin 5 dhe 10 të Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil pozita e Drejtorit të Përgjithshëm në Inspektoratin e Arsimit është përcaktuar me të njëjtin status gjegjësisht është pozitë e barasvlefshme me pozitën e drejtorëve të përgjithshëm të agjencive ekzekutive dhe si e tillë kategorizohet si pozitë e nivelit të lartë drejtues me afat të caktuar.

Pas konstatimit si në arsyetimin e këtij vendimi se pozita të cilën e ka mbajtur ankuesi "Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit" është pozitë e Kategorisë së Lartë Drejtuese, Kolegji i Këshillit duke marr për bazë dispozitat e nenit 15 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, për pozitat e Kategorisë së Lartë Drejtuese, mandati ka qenë tre (3) vjet, ndërsa me dispozitat e nenit 42 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku për pozitat e Kategorisë së Lartë Drejtuese mandati është katër (4) vjet, dhe mbi këtë bazë dhe asaj që u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi Kolegji konstatoi se mbajtja e një pozitë të Kategorisë së Lartë Drejtuese pa afat, është veprim në kundërshtim me dispozita e ligjit material në fuqi dhe atij paraprak, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me kthimin e ankuesit në pozitën e punës sipas Aktit të Emërimit të datës 03.10.2016, është i pabazuar.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, Kolegji konstaton se njësi përgjegjëse për emërimin dhe lirimin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues për institucionet e administratës shtetërore është Qeveria përkatësisht ministria përkatëse për administratë publike siç është përcaktuar me nenin 40 dhe nenin 61 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që mbi këtë bazë të konstatimit rezulton së vendimi i kontestuar më ankesë është nxjerrë nga organi jo kompetent dhe si i tillë është i paligjshme në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj mbi këtë bazë të konstatimit rezulton se pretendimi ankimor mbi këtë fakt është i bazuar.

Për me tepër, siç u përcaktua me lartë se në raport me pozitat e nivelit të lartë drejtues, si njësi kompetente është Qeveria/Ministria përkatëse për Administratë Publikë, tani Ministria e Punëve të Brendshme, Kolegji i Këshillit thekson faktin, së kjo e fundit, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka qenë e detyruar të bëjë rregullimin e statusit të pozitave të cilat kanë pësuar rregullim ligjor, qoftë në kuptim të statusit, kategorisë apo afatshmerisë, siç është rasti me pozitën e ankuesit, si dhe të bëjë sistemin e tyre, duke aplikuar në analogji dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 dhe nenit 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Referuar rrethanave dhe konstatimet si më sipër, kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që të aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e ankuesit, të anulohet Vendimi me numër Nr.prot.2357 i datës 20.09.2023, i Ministres së Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe të obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të bëjë sistemimin e ankuesit në pajtim me dispozita përkatëse në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1237/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Avokatit
- Ministres së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.